



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.272/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtar Gent Bekeri, në çështjen përbarimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë, me seli në Prishtinë, Rr. “UÇK”, nr.51, kundër debitorëve D.P.H “BOSS”, me NRB:80051727, me seli në Prizren, Rr. “Rrasat e Koshares”, nr.31, E.K., nga Prizreni, Rr. “...”, nr.8, T.T., nga Prizreni, Rr. “...”, p.n, B.K., nga Prizreni, Rr. “...”, nr...., A.M., nga Prishtina, Rr. “...”, p.n dhe A.B., nga Prizreni, Rr. “...”, nr..... duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit A.M., të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.561/16 të datës 04.10.2016 të Përbaruesit Privat Mehdi S.Reshani, me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 18.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit A.M., nga Prishtina, Rr. “...”, p.n, i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.561/16 të datës 04.10.2016, të Përbaruesit Privat Mehdi S.Reshani.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.561/16 të datës 04.10.2016, i Përbaruesit Privat Mehdi S.Reshani.

A r s y e t i m

Përbaruesit Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përbarimor me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të Marrëveshjes mbi Kredinë nr.200684202, Shtojcës nr.2 për rikonstukturimin e kredisë nr.200684202, Marrëveshje mbi Hipotekën nr. 200684202/H, listat e pengut dhe lista e pengut nga zyra e regjistrimit të pengut, Marrëveshjes mbi Hipotekën nr.200684202/H, Aktvendimit mbi regjistrimin e hipotekës me nr.prot:07-027-9288/H, të datës 27.08.2012, duke detyruar debitorët të paguajnë shumën prej 23,638.1 €, si dhe kamatën e rregullt dhe kamatëvonesën që do të arrij deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore të gjithë këtë në afat prej 7 ditësh. Bllokohen të gjitha llogaritë nëpër të gjitha bankat komerciale në emër të gjithë

debitorëve duke bërë pagesën me bartje të mjeteve nga llogaria e debitorëve në llogarinë e kreditorit, nëse Përmbaruesi Privat apo kreditori mëson për ekzekutimin e mjeteve në ndonjë llogari. Sekuestrohet kolaterali i cili përbëhet nga a). Pajisje për prodhim, Invertar-Lënda e parë (pronë e kompanisë D.P.H “BOSS”, b). Mjete Opel Frontera Sport 4x4 me targa 04-631-DG (pronë B.K.), c). Pikap Citroen C15 me targa ... (pronë e T.T.), d). Veturë VW 1 J me targa ... (pronë e A.M.), e). Veturë Suzuki Liana me targa ... (pronë e E.K.), dhe i njëjti ti dorëzohet kreditorit për ta shitur që ta realizoj kërkesën e vet ndaj debitorit. Po ashtu është lejuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorit me shitjen, zbrazen dhe dorëzimin në pronësi dhe posedim të paluajtshmërisë, kreditorit (duke e liruar paraprakisht nga njerëzit-debitori apo kushdo qoftë që haset në posedim dhe gjësendet), e evidentuar në ngastrën kadastrale nr. P-... tokë (përfshirë shtëpinë që nuk figuron në certifikatë por e deklaruar nga pronari), e identifikuar me certifikatën nr. UL-..., ZK Prizren, në sipërfaqe prej 304 m2, pronë e A.R.B., konform dispozitave të Ligjit 199, ligj për pronësi dhe të drejta tjera sendore dhe Ligji Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, neni 220, 222 dhe neni 242.2 të LPP-së, për realizimin e kërkesës së kreditorit ndaj debitorit.

Kundër urdhrin përmbarimor në afatin e paraparë ligjor prapësim ka ushtruar debitori i përmbarimit A.M., duke theksuar se përmbaruesi privat gjatë shqyrtimit të lëndës ka bërë shkelje të dispozitave materiale kur ka vendosur lidhur me propozimin për përmbarim, ngase sipas nenit 40 të LPP-së propozimi për përmbarim duhet të përmbaj kërkesën sipas paragrafit 1 të nenit 38 të këtij ligji, ndërsa sipas paragrafit 1.3 të nenit 40 dokumentet duhet të jenë origjinale apo fotokopje të vërtetuara, e të cilat prova materiale deri më tani kreditori nuk i ka dërguar tek debitori, e që ka pasur obligim ligjor që ti dërgojë së bashku me propozim dhe urdhrin dhe urdhrin përmbarimor në mënyrë që të dëshmohet se debitori A.M., a ka qenë garantues dhe nënshkrues i këtyre marrëveshjeve të cekura si prova në propozimin përmbarimor apo ndonjë dokument tjetër të besueshëm me të cilat prova ka vendosur përmbaruesi privat, e të cilave u'a ka falur besimin për të nxjerrë urdhrin përmbarimor. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, ndërsa urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.561/2016 i datës 04.10.2016 të anulohet, gjegjësisht propozimi për përmbarim të refuzohet si i pa bazuar.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se përmbaruesi privat ka vepruar në mënyrë të drejtë me lejimin e përmbarimit të propozuar nga kreditori, dhe si i tillë paraqet titull ekzekutiv në kuptim të nenit 22 të LPP-së, pasi që të njëjtit i janë bashkangjitur marrëveshja mbi kredinë e nënshkruar në bazë të vullnetit të lirë të palëve kontraktuese,

Shtojca nr.2: për rikonstruktivimin e kredisë, Lista e Pengut për sigurimin e kredisë, si dhe konfirmimi i regjistrimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht zyra për regjistrim të pengut, si në shkresat e lëndës, me nënshkrimin e të cilave dihen qartë obligimet dhe detyrimet të cilat duhet ti përmbushin palët debitorë ndaj kreditorit. Tutje ka theksuar se prapësimi i ushtruar nga ana e debitorit është plotësisht i pathemeltë dhe i pa bazuar, pasi që debitori asnjë nga shkaqet e prapësimit të parapara sipas nenit 71 të LPP-së, nuk i ka mbështetur me asnjë provë. Debitori dhe kreditorit me datën 16.08.2012 kanë nënshkruar Marrëveshjen mbi Kredinë nr.200684202 për shumën 20,000.00 €, si dhe me datën 20.12.2013 kanë nënshkruar Shtojcën nr.2 për rikonstruktivimin nr.200684202 në shumë prej 16,510.00 €, si në shkresat e lëndës, ku nga të njëjtat shkresa del qartë garantuesi i pesë A.M. është nënshkruar i po të njëjtave marrëveshje si në shkresat e lëndës. Debitori-garantuesi gjatë përpilimit të prapësimit ka pohuar se unë nuk jam në njohuri se a janë përmbushur obligimet e kredisë, mirëpo pohimi i tillë është i paqëndrueshëm dhe jo i saktë, sepse ne si kreditor kemi pasur takime të shpeshta me garantuesin dhe i njëjti është informuar detajshëm për ngecjet e pagesave. Po ashtu debitori e ka cekur se unë në cilësinë e debitorit të 5 nuk jam garantues i kredisë së debitorit të parë dhe debitorit të dytë, mirëpo një pohim i tillë nga garantuesi është i pa bazuar dhe nuk është mbështetur në asnjë provë. Pra si mund të vetëquhet i liruar prej cilësisë së garantuesit kur i njëjti është nënshkruar i marrëveshjeve si në shkresat e lëndës. Duke u bazuar në nenin 39 të LPP-së, ku parashihet “Përmbartimi ndaj debitorit me përgjegjësi solidarë” shihet qartë se ndaj të gjithë debitorëve mund të vepronhet njëjtë deri në përmbushjen e obligimit ndaj kreditorit, pasi që të njëjtit janë nënshkruar të marrëveshjes dhe të njëjtat janë nënshkruar me vullnet të plotë dhe pa kurrfarë imponimi, andaj, edhe përgjegjësia e debitorëve ekziston deri në përmbushjen në tërësi të obligimit. Faktikisht përmbartuesi privat ka vepruar pikërisht sipas dispozitave të nenit 38 par.1 dhe nenit 40 të LPP-së, ku të njëjtin propozim e ka lejuar dhe dërguar palëve debitore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se dokument përmbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin përmbarues përkatësisht Marrëveshja mbi Kredinë nr.200684202, Shtojcës nr.2 për rikonstruktivimin e kredisë nr.200684202, Marrëveshja mbi Hipotekën nr. 200684202/H, listat e pengut dhe lista e pengut nga zyra e regjistrimit të pengut, Marrëveshja mbi Hipotekën nr.200684202/H, Aktvendimit mbi regjistrimin e hipotekës me nr.prot:07-027-9288/H, të datës 27.08.2012, të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.7, nenit 27 të LPP-së dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, për tu paraqitur si dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, pasi që Marrëveshja mbi Hipotekën nr.200684202/H, është e regjistruar me Aktvendimit mbi regjistrimin e hipotekës me nr.prot:07-027-9288/H, të datës 27.08.2012, dhe kopja e marrëveshjes së tillë është e vërtetuar me vërtetimin LRP:4088/2016 pranë organit kompetent, e po ashtu listat e pengut janë të regjistruar me Konfirmimin e Regjistrimit R-....

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarimore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm
KPPP.nr.272/22, datë 18.08.2023

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.